



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

*Komisioni Posaçëm për Reformën Zgjedhore*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 01.12.2017, ora 12:30

**Drejtojnë mbledhjen:**

**Bledar Çuçi– Kryetar    Oerd Bylykbashi - Kryetar**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 10.12.2017.
2. Paraqitja e pozicioneve të partive politike.
3. Propozime për grupin e ekspertëve.
4. Propozime për planin e punës dhe kalendarin e aktiviteteve.
5. Çështje të tjera.

**Marrin pjesë:**

Bledar Çuçi, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Ermonela Felaj, Alket Hyseni, Adnor Shameti, Klotilda Bushka, Blerina Gjylameti, Musa Ulqini, Bashkim Fino, Vangjel Dule, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Nasip Naço, Nard Ndoka, Dashamir Shehi dhe Fatmir Mediu.

**Mungon:**

Luan Rama.

**Të ftuar:**

Liljana Kaci – përfaqësuese e Këshillit të Europës

Robert Adams – përfaqësues i Delegacionit të BE-së në Shqipëri

Dorarta Hyseni – përfaqësuese e Delegacionit të BE-së në Shqipëri

Florian Hobdari – përfaqësues i OSBE-së

## HAPET MBLEDHJA

**Oerd Bylykbashi** – ...përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, prezent kemi edhe përfaqësuesit e medias, hapim këtë mbledhje, që, në fakt, është mbledhja e parë e komisionit që pas konstituimit.

Gjykoj se, duke konsideruar edhe situatën e përmbytjeve aktualisht në terren, kjo mbledhje duhet të fokusohet në arritjen e konkluzioneve të punës sonë për axhendën e sotme sa më shpejt. Besoj se edhe mediet do ta mirëkuptojnë që vetëm pjesa e parë e mbledhjes do të jetë e mbuluar prej tyre, duke vijuar më pas me dyer të mbyllura për ta fokusuar diskutimin sa më efektiv të çështjet e punës, sepse edhe deputetët e kanë të nevojshme të gjenden pranë zonave të përmbytura.

Sot në këtë mbledhje kemi përcaktuar si rend dite atë që është e domosdoshme për fillimin e punës së këtij komisioni dhe besoj se çështja e parë do të jetë një prezantim i shkurtër nga forcat e përfaqësuara në këtë komision të pozicioneve të tyre në lidhje me çështjet që mendojnë se duhet të përfshihen në programin e punës së Komisionit të Reformës Zgjedhore, si ngritja e grupit të ekspertëve, të cilin më pas ta ngarkojmë me punë për të hartuar një plan veprimi dhe kalendarin e aktiviteteve mbi bazën e asaj që do të diskutojmë sot këtu.

Fjala për ju, zoti Çuçi, nëse keni diçka.

Faleminderit!

**Bledar Çuçi** – Nuk kam asgjë për të shtuar, veçse sugjeroj të fillojmë menjëherë nga mbledhja, me pikën e parë të axhendës, me miratimin e procesverbalit të datës 10.11.2017, i cili besoj se është vënë në dispozicion nga shërbimet e Kuvendit për gjithsecilin.

Biem dakord të gjithë me procesverbalin? Kundër? Nuk ka.

Në rregull.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

Do t'u lutesha të gjithë kolegëve të fokusoheshin te çështjet që ata mendojnë se duhen diskutuar te ky komision, pavarësisht nga problemet dhe çështjet e shtruara në mbledhjen e parë nga dy bashkëkryetarët, në mënyrë që të kemi një program sa më të gjerë dhe shterues të funksionimit të këtij komisioni.

Po ashtu, do t'ju lutesha të fokusoheshim, në mënyrë strikte, pikërisht te çështje që do t'i futim në axhendë, që do të jenë në dispozicion të ekspertëve për të përcaktuar kalendarin për funksionimin e këtij komisioni.

Kështu që, duke filluar ndoshta nga kolegët e opozitës...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po.

Besoj se edhe mediet duhet të na mirëkuptojnë që sot, edhe për shkak të situatës, ta ndërpresim këtu transmetimin medietik, ndoshta mund të merrni ndonjë plan dhe të largoheni, në mënyrë që të vazhdojmë punën e komisionit.

Natyrisht, gazetarët janë të lirë të qëndrojnë, ndërsa kamerat jo.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Oerd Bylykbashi** – Atëherë, të nderuar kolegë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Si? T'i nxjerr?

Çfarë do të bëjmë? Atëherë, do ta mbyllim...?

Të nderuar kolegë, ashtu siç e lamë, në bazë të rendit të ditës...

*(Diskutime në sallë.)*

Adnor, të lutem!

Atëherë, si pikë të parë të rendit të ditës kemi paraqitjen e pozicioneve politike që kanë partitë në lidhje me çështjet që mendojnë se duhen trajtuar.

Në këtë aspekt, sigurisht, të gjithë ne bazohemi te konstatimet, gjetjet, problematikat e para nga secili prej nesh në procesin zgjedhor të vitit 2017, të vitit 2015 dhe të vitit 2013, sepse të tria këto palë zgjedhje nuk janë trajtuar nga një Komision Reforme për sa u përket problematikave. Sigurisht, një pjesë e kësaj reflektohet te raportet e OSBE-ODIHR-it, të cilët në të tria këto palë zgjedhje kanë setin e tyre të rekomandimeve, që nuk janë trajtuar pothuajse fare.

Për të mos u zgjatur, unë besoj se këto janë çështje qëndrimesh që gjithsekush prej nesh i konsideron si të rëndësishme për t'u trajtuar nga ky komision, madje është edhe objekt i punës i përcaktuar nga Kuvendi, që duhet të marrë në konsideratë edhe propozimet e partive politike.

Në këtë këndvështrim, Partia Demokratike konsideron se një element thelbësor që duhet të ketë reforma zgjedhore është dekriminalizimi i procesit zgjedhor. Kjo jo vetëm në aspektin e asaj që deri sot ne njohim si problematikë, pra prezenca e personave me rekorde kriminale në proces, ajo sigurisht. Pra, ne kemi një nevojë të harmonizojmë ligjin e dekriminalizimit me Kodin Zgjedhor dhe me legjislacione të tjera, por, mbi të gjitha, duhet të bëjmë përpjekje efektive, që procesi zgjedhor të jetë sa më i pastër nga influencat kriminale. Sigurisht, kjo do të kërkojë ndërhyrje në Kodin Zgjedhor, mund të kërkojë ndërhyrje edhe në ligje të tjera, për të forcuar kështu kornizën ligjore, që çon në mbrojtjen e procesit zgjedhor nga

influenca kriminale. Pra, nuk duhet ta shohim vetëm si diçka që është në optikën e Kodit Zgjedhor, por propozimet që do të vijnë nga ekspertët do të na tregojnë edhe se ku ne duhet të ndërhyjmë në këtë kuadër.

Një çështje që ky komision duhet marrë në konsideratë, që lidhet me çështjen e parë, është forcimi i politikës penale. Janë bërë hapa në fillim të procesit zgjedhor që shkoi, pra pak para se të fillonte, duke bërë një sërë ndërhyrjesh në Kodin Penal, duke krijuar vepra të reja, ose duke rikualifikuar veprat ekzistuese, ku, për shembull, shitblerja e votës konsiderohet tashmë si korrupsion zgjedhor dhe me një qëllim të qartë, që jo vetëm të forcohej dhe të detajohej më mirë si dispozitë, por edhe të kalonte juridiksioni i ndjekjes së asaj veprë penale te krimet e rënda dhe eventualisht sapo të ngrihet te strukturat e SPAK-ut. Pra, hetimi, ndjekja penale dhe më pas dënimi i këtyre veprave të marrë jo vetëm optikën e nevojshme, fokusin dhe ekspertizën e nevojshme, por të jetë edhe më efektive në fund fare të asaj që presim të gjithë, dënimin e personave të përfshirë në krime zgjedhore.

Parlamenti e ka shprehur tashmë vullnetin në lidhje me këtë dhe jo vetëm me këto ndryshime në Kodin Penal, por edhe në ligjin e dekriminalizimit, ku ndalimi për persona të këtyllë, njësoj si për ata që kryejnë korrupsion, është 20-vjeçar pas dënimit penal.

Një pjesë e kësaj pune, sigurisht nuk është çështje ndryshimesh zgjedhore, por do të jetë e nevojshme rritja e politikës penale nga organet, të cilat merren me zbatimin e kësaj.

E lidhur ngushtësisht me optikën e dekriminalizimit të procesit zgjedhor, por me një prioritet shumë të madh për sa na përket neve, është përdorimi i teknologjive në votim, pra futja e identifikimit elektronik, votimit elektronik dhe numërimit elektronik në procesin zgjedhor. Janë një sërë problemesh që lidhen drejtpërdrejt me këto pjesë të procesit zgjedhor, të cilat tashmë janë të kontrolluara, jo të prekura, por të kontrolluara thelbësisht nga sjellje kriminale qoftë zyrtarësh shtetërorë apo politikë, qoftë nga organizime kriminale të cilat janë të lidhura me to. Marrja e kartave të identitetit, përdorimi i këtyre kartave për ta kapuar votën, kontrolli i votës nëpërmjet këtij instrumenti apo edhe mohimi i së drejtës së votës janë shembuj në këtë drejtim, por, po ashtu, ne e dimë shumë mirë se ekziston problemi i ngritur prej jush, problemi i ngritur prej nesh ndër vite, ai i korrupsionit zgjedhor të komisionerëve zgjedhorë qoftë në qendrat e votimit apo në qendrat e numërimit, numërim i cili ka pasur vazhdimisht probleme të qarta numri. Për shembull, rasti i Lezhës në vitin 2013 ishte një rast i ekspozuar në KQZ, i cili tregoi se numërimi me shkelje kriminale, përfshirë edhe falsifikimin në dokumentacionin e çuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kishte zhvendosur një mandat.

Në këtë aspekt, futja e votimit dhe e numërimit elektronik, si dhe identifikimit biometrik, i cili, për shembull, do të na zgjidhë problemin e mospasjes nevojë për përdorimin e kartës së identitetit apo e abuzimit me rekordin e emigrantëve e të tjerë. Të gjitha këto do të jenë të kombinuara me elemente të tjerë. Do të jetë një ndryshim i rëndësishëm në procesin zgjedhor.

Ne gjykojmë se kjo çështje duhet të trajtohet me prioritet në kuadër të reformës zgjedhore. Sigurisht, nuk po e ezauroj këtë, sepse do të kemi mundësi ta diskutojmë në vijim në këtë komision.

Një nga problemet thelbësore, që u pa edhe nga raporti i OSBE-ODIHR-it, është përdorimi i burimeve shtetërore dhe presioni mbi administratën, problem i cili ka ardhur në rëndim të tillë, që është rekomandimi prioritar nr. 3 në raportin e ODIHR-it, dhe në substancë është rekomandimi nr. 2. Sigurisht, ka aspektin e tij kriminal. Këto janë vepra penale të parashikuara në Kodin Penal, megjithatë duke mos ndodhur asgjë, sensi i impunitetit ka çuar që presioni mbi administratën është i tillë që është i dukshëm, është në sytë e të gjithëve, por tashmë ka arritur edhe deri te privati. Pra, raporti i ODIHR-it nënvizon faktin se edhe te privati bëhet presion me vendin e punës në këmbim të votës. Kështu që kjo është çështje e një rëndësie të tillë, që e ka bërë OSBE-ODIHR-in të ngrejë një institucion të pavarur, që do të merret me këtë çështje dhe do të jetë objekt i diskutimit tonë. Pra, do të kemi ndryshime në ligj, do të kemi ngritje institucionesh, do të kemi eventualisht edhe shtrëngim të akteve nënligjore, të cilat ndihmojnë në këtë kuadër.

Komisioni do të supervizionojë dhe do të bëjë edhe ndryshimet e nevojshme, aty ku është e nevojshme për t'i bërë.

Një problem tjetër që mbetet, gjykoj se është roli i policisë në zgjedhje. Në qoftë se në vitin 2002 e hoqëm policinë nga zgjedhjet, një problem shumë i madh në zgjedhjet e vitit 2001 dhe për një numër të konsiderueshëm vitesh policia nuk ishte më një problem. Sot problemi është mosveprimi i policisë kur është e nevojshme për të ndërhyrë dhe për të larguar elementët kriminalë nga procesi zgjedhor. Pra, është e nevojshme që, me një balancë shumë të kujdesshme, duke qenë se policia është përsëri e përfshirë në kuadrin e problemit të përdorimit të burimeve shtetërore, të shihet me kujdes roli i policisë në këtë proces.

Një çështje me rëndësi shumë të madhe është financimi i partive politike qoftë në procesin zgjedhor, qoftë në procesin politik të përgjithshëm dhe transparenca e tyre përfshirë, mbi të gjitha, uljen e kostos së politikëbërjes. Në këtë aspekt, duhet që korniza ligjore të jetë e tillë, që jo vetëm garanton standarde minimale, por duhet të jetë efektive, në mënyrë që kostot

e fushatës të jenë të ulëta dhe burimet të jenë sa më të qarta. Mundësisht, në propozimin tonë, pjesa më e madhe e burimit duhet të vijë nga një burim financimi shtetëror, në mënyrë që të jetë më i kontrollueshëm, më transparent dhe më pak i ndikuar nga financime të errëta. Kjo do të na bëjë të mundur që më pas ky si problem të dalë nga, le të themi, fusha e problemeve të konstatuara në gjithë këto zgjedhje. Sigurisht, kjo nuk do ta zgjidhë aspak financimin kriminal që bëhet në procesin zgjedhor, i cili nuk kalon nga llogaritë e partive politike, por partitë politike mund të jenë beneficiare dhe drejtpërdrejt të kësaj çështjeje. Në këtë kuadër, do të kemi nevojë për të ndryshuar ligje, si dhe për të parë rolin e institucioneve të tjera, të cilat do të kenë në dorë zbatimin e këtyre dispozitave.

Për sa i përket çështjes së medias dhe fushatës, besoj se kjo po kthehet tashmë në një problematikë që duhet trajtuar me kujdes. Korniza aktuale është –e dakordësuar për herë të fundit në vitin 2002, me pak ndryshime rrugës dhe nuk i reflekton më zhvillimet që ka aktualisht media. Në vitin 2002 kur u bënë ndërhyrje, media kontrollohej nga qeveria. Ndërhyrjet e asaj kohe e stabilizuan, por tashmë forma të tjera kanë bërë që media, gjithashtu, të kthehet në një problem, i cili duhet zgjidhur me patjetër.

Kontrolli qeveritar mbi mediet, i cili del në raportet e vitit 2015 dhe vitit 2017 të OSBE-ODIHR-it, ka bërë që media të mos reflektojë më atë që është liria e kandidatëve për të bërë fushatë, liria e zgjedhësve për t'u informuar, qoftë edhe liria e medias për të raportuar në mënyrë transparente dhe të drejtë atë që ndodh në procesin zgjedhor. Kështu që edhe kjo çështje duhet qasur në përputhje me standardet ndërkombëtare e, mbi të gjitha, me realitetin shqiptar.

Një problem i madh në këndvështrimin tonë, që duhet zgjidhur dhe po rikthehet pas zgjidhjesh shumë të suksesshme në të shkuarën, është çështja e listave të zgjedhësve dhe sistemit të adresave. Listat e zgjedhësve dolën nga kolapsi i jashtëzakonshëm i viteve 2000-2003 nëpërmjet një modernizimi të regjistrit të gjendjes civile dhe prodhimit të kartave të identitetit. Gjëja që duhet përmbyllur në sekuencën e tyre ishte edhe sistemi i adresave, që aktualisht nuk ekziston. Për këtë arsye, përveçse ka informacione të përdorimit të bazës së të dhënave në mënyrë politike, ajo që është më e rëndësishme në kuadër të zgjedhjeve në të ardhmen është që zgjedhësit duhet të kenë një adresë të qartë të përcaktuar me ligj. Kjo nuk ekziston aktualisht. Kjo bën të mundur që zgjedhësit të zhvendosen, për shembull, nga Tirana në Durrës dhe për këtë është e provuar; të merren nga qarqe të tjera dhe të çohen për të votuar atje ku kanë të regjistruar adresën në mënyrë fiktive në numra të mëdhenj, për të ndikuar rezultatin e zgjedhjeve në një qark të caktuar.

Po ashtu, mungesa e informacionit të besueshëm bën që të dhënat e zgjedhësve, të cilët janë emigrantë, të përdoren në këtë kuadër për votim në emër të personave të tretë, pra në emër të emigrantëve, duke qenë kështu përpara një krimi zgjedhor. Ndaj, besoj se ne e kemi të nevojshme që ky proces reforme ta trajtojë me fokus përsëri diçka që ishte zgjidhur në të shkuarën, për shkak të ndryshimeve thelbësore, që kanë ndodhur në aspektin praktik në kundërshtim me standardet dhe me ligjin.

Për ne një çështje shumë e rëndësishme, që besoj e ndajmë në këtë pikë, lidhet me votimin e emigrantëve. Kemi të bëjmë me një grup shumë të madh zgjedhësish, i cili ndodhet jashtë Republikës së Shqipërisë dhe të dhënat e INSTAT-it për emigracionin e viteve të fundit tregojnë se pjesa më e madhe e tyre, që janë larguar nga Shqipëria në tre-katër vjetët e fundit janë votues aktivë. Sigurisht, edhe në raport me demografinë në emigracion, numri i personave me të drejtë vote është më i madh sesa i atyre që nuk kanë të drejtën e votës, pra është një problem i cili duhet parë në planin kushtetues (e drejta e votës dhe ndikimi i kësaj mbi zgjedhjet në Shqipëri); në planin ligjor (zgjidhjet që ne duhet të gjejmë, pra kush është sistemi), si dhe në planin praktik (implementimi i kësaj).

Qëndrimi ynë është në favor të gjetjes së një zgjidhjeje për t'i dhënë mundësinë një votimi efektiv, sigurisht duke garantuar që mënyra si do të votojnë emigrantët nuk dëmton, nuk cenon, jo për fajin e emigrantëve, por për fajin e sistemit të manipulueshëm apo defektoz të hedhjes së votës së tyre dhe nxjerrjes së rezultatit. Pra, është e nevojshme të bëjmë një punë shumë serioze dhe të thelluar me ekspertizën më të mirë për të gjetur zgjidhje në këtë drejtim.

Ndër të tjera, do të jetë e nevojshme për të diskutuar për elemente që kanë lidhje edhe me sistemin zgjedhor. Këtu pastaj është e hapur për të diskutuar. Sigurisht, gjëja kryesore që ne si komision duhet të bëjmë është të garantojmë standardet e një terreni loje sa më solid për aktorët në garë, por edhe brenda sistemit aktual, mund të lindë nevoja që të shtrëngohen elemente të caktuara për të evituar abuzime, siç mund të jetë përdorimi i siglave fiktive në proces për të kontrolluar votën në mënyra edhe me mekanizma mafiozë, praktikisht të përdorura edhe në vende të tjera, që kanë filluar të përdoren në Shqipëri.

Besoj se çështja e fundit për sa i përket këtij prezantimi nga ana jonë, është çështja e referendumeve. Pra, ne duhet të shohim me kujdes nevojën për të rishikuar kornizën ligjore të referendumeve. Korniza aktuale daton në vitin 2000, është e pandryshuar që nga ai vit, ekziston nëpërmjet një dispozite transitore, që lë në fuqi nenet e vitit 2003, që transpozonte po ato të vitit 2000, pra është shumë e vjetër dhe është e ndërtuar praktikisht kundër referendumeve.

Nuk është e mundur të bëhen referendume. Pra, që nga viti 1998 ka qenë e pamundur që mbi bazën e këtij ligji të bëheshin referendume.

Ndërkaq, duke mbajtur një balancë të kujdesshme midis nevojës për ta forcuar këtë instrument të demokracisë së drejtpërdrejtë, nga ana tjetër, kjo duhet të mbetet në suazën e demokracisë përfaqësuese parlamentare. Pra, t'i japim mundësinë që kjo të ndodhë, por, nga ana tjetër, të jetë diçka e balancuar në mënyrë të kujdesshme me pjesën tjetër të kornizës. Ky ishte një prezantim i këtyre problematikave në mënyrë të qetë, por sigurisht të gjitha këto problematika (një pjesë e madhe e tyre), janë me teh shumë të mprehtë dhe plagët janë shumë të forta në proces. Ne duhet ta mendojmë kështu. Problemet mbeten të paprekura dhe të pazgjidhura nga ne. Nuk ka rëndësi se kush është pala. Në një moment apo në një tjetër, gjithkush dëmtohet dhe mbi të gjitha, dëmtohen zgjedhësit.

Këto probleme që ne shtrojmë, të listohen. Nuk besoj se kjo është çështje për debat. Ky komision duhet t'i marrë, t'i diskutojë dhe t'u gjejë zgjidhje reale këtyre problemeve që ne konstatojmë, pavarësisht se kush i prezanton.

Ju falënderoj për vëmendjen!

Fjalën e kanë kolegët!

**Bashkim Fino** – Faleminderit!

Mua më duket pak politike. Unë ju dëgjova me vëmendje, megjithëse e morët fjalën si bashkëkryetar, por po ta dija më parë do të kisha ndërhyrë më përpara. Mua më duket pak e tepërt, e tejkaluar, e ezauruar do të thosha. Ju e dini që është bërë një debat i gjatë në Kuvendin e Shqipërisë më 13 tetor, në ditën kur u miratua ngritja e këtij komisioni. Asnjëherë tjetër nuk është bërë një debat i tillë në Kuvendin e Shqipërisë për ngritjen e komisionit. Atje të gjitha forcat politike, edhe ne, si PS, edhe ju që ju kam pasur të gjithëve, pa përjashtim folët dhe trajtuat problemet politike të partive tuaja, problematikën që ka në objekt edhe OSBE/ODIHR-i, edhe problematikën që ju keni dashur të trajtoni në mbledhjen e Kuvendit të Shqipërisë. Mua më duket e tepër kjo zotërinj bashkëkryetarë, që të ridëgjojmë përsëri po të njëjtat gjëra, që zoti Bylykbashi, me gjithë respektin që kam, i përmblodhi (pavarësisht se harxhoi shumë minuta) të të gjitha atyre diskutimeve që u bënë nga anëtarët e PD-së në Kuvendin e Shqipërisë më 13 tetor, madje mbase ka akoma edhe shumë të tjera për të thënë, ndërkohë që ne duhet të ngremë sa më shpejt grupin e ekspertëve, duhet të miratojmë planin e punës dhe kalendarin e aktivitetit dhe t'u japim detyra ekspertëve, qoftë tuajve, qoftë tanëve për të filluar për të na mbushur ne me punë në mbledhjet e ardhshme për të filluar dhe për të trajtuar çështjet që tashmë dihen. Pra, u diskutuan, u dëgjuan në Kuvend dhe u ngrit ky komision i nderuar.



Të më falni, por e quaj kohën shumë flori edhe në rastin konkret dhe në diskutimet që siç u nisën të bëjnë, apo ato që mund të bëjmë edhe ne, më duken të tepërta, të tejkaluara, sepse janë trajtuar një herë.

Ju falënderoj për mirëkuptimin!

**Bledar Çuçi** – Faleminderit zoti Fino!

Duke mbështetur edhe fjalën tuaj do të doja t'ju sjell në vëmendje që zoti Bylykbashi nuk bëri asgjë tjetër, veçse parashtrroi si pika gati shteruese.

Unë kam për të shtuar disa pika edhe kolegët mbase do të shtojnë për çështjet që ky komision do t'i duhet të merret. Duke marrë shkas edhe nga shtesa juaj në lidhje me debatin politik që ka qenë shterues në seancën plenare, do t'ju lutesha kolegëve që të mos merren fare më me çështje politike, por nëse do të kenë çështje të tjera, jashtë atyre që parashtrroi zoti Bylykbashi, t'i diskutojmë këtu në mënyrë që të furnizojmë më pas edhe ekspertët për të bërë një axhendë dhe një kalendar sa më të plotë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po i mbajmë shënim.

Jo, jo. Ju lutem, zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Mos më kthe përgjigje për Bylykbashin se ma kthen vetë ai mua!

Apo tani jeni bashkëkryetarë të dy bashkë...

**Bledar Çuçi** – Ju lutem!

Ne po vendosim dhe po mundohemi të hedhim në tryezë të gjitha çështjet që do të diskutojë ky komision dhe do të bëjmë një axhendë sa më të plotë, që të jemi sa më gjithëpërfshirës.

Nisur nga ajo që thatë ju, unë u bëj thirrje kolegëve që të mos merremi pikërisht me çështje politike, por të merremi vetëm me çështje, të cilat kanë të bëjnë me axhendën e këtij komisioni. Besoj se zoti Bylykbashi numëroi një numër të konsiderueshëm të çështjeve me të cilat duhet të merremi këtu. Unë besoj se ishte e plotë, pavarësisht se ka edhe çështje të tjera. Fjala që bie, unë do të shtoja se duhet të merremi shumë seriozisht me një problem që është edhe rekomandim i OSBE-së, që lidhet me depolitizimin e klimës në komisione, depolitizimin e komisioneve zgjedhore poshtë në bazë, gjëra që zoti Bylykbashi nuk i preku, por që ne duhet të merremi me to dhe kjo është një çështje që unë e shtroj këtu në këtë tryezë që ta vendosim në axhendë edhe këtë çështje. Në këtë frymë, besoj se çdokush që ka gjëra për të shtuar, për të thënë, për ta plotësuar axhendën, sot është dita për t'i thënë. Pa diskutim, lista nuk është e mbyllur, sepse mund të na dalin rrugës çështje të tjera për të cilat do të duhet të diskutojmë në

këtë komision. Rruga është e hapur, por të paktën të bëjmë një axhendë dhe një kalendar sa më të plotë për funksionimin e këtij komisioni. Çdo koleg është i mirëpritur (pa u zgjatur), për të shtuar, nëse ka gjëra të tjera nga këto që u thanë këtu, edhe nga ne si bashkëkryetarë për të bërë një axhendë sa më të plotë.

Fjala është për ju!

**Bashkim Fino** – Fola për çështje procedurale dhe duhet të më mirëkuptojnë kolegët. Nuk ka ndonjë problem nëse nuk më mirëkuptoni, mund të vazhdoni të flisni, por duhet ta di edhe nga ju që ju jeni dakord të vazhdojmë me debat, sepse nuk po merrem me kryetarin tim. Kujt po ia themi këto? Nuk po ia themi asnjëri. Nuk po diskutoj për mediet, se mediet e dinë.

Duhet të kishim ekspertët këtu të kishim një plan tërë dhe t'ia thoshim që do të merrnin këto detyra: 1,2,3,4 dhe i fillonim me radhë, se ky është komision pune. Nëse e quani seancën e sotme një deklaram politik të 13 tetorit, unë tërhiqem dhe ju kërkoj falje që ndërhyra.

**Oerd Bylykbashi** - Faleminderit zoti Fino, për fokusimin e çështjes që ngrini!

Ne e kemi edhe nga eksperiencia e shkuar e komisionit, që nuk për funksionoi përtej mbledhjeve të para, por kjo që po bëjmë ne, është procedurë rutinë. Ne nuk po bëjmë diskutim politik, por vetëm po listojmë çështjet. Ajo që përmendi zoti Çuçi sigurisht që i shtohet, por është edhe në raportin e OSBE/ODIHR-it dhe ne do t'i listojmë edhe ato si çështje.

Kemi këshilltarët e komisionit, të cilët mbajnë shënim problematikat. Ne do të asistojmë që lista të jetë e plotë dhe sapo të ngrihet grupi i ekspertëve, ta ketë listën dhe ata fillojnë të zhvillojnë një plan pune për komisionin. Pra, detyra që ne duhet t'i caktojmë këtij komisioni dhe grupit të ekspertëve, që duhet të ngremë sot, është që brenda një harku kohor jo të gjatë, maksimumi 7-10 ditë nga momenti që ekspertët të jenë të konstituuar, të na sjellin një plan pune dhe eventualisht, një kalendar për tematikat e ndryshme që do të jenë për diskutim. Prandaj ky diskutim vlen për të listuar dhe jo për të debatuar çështjet. Është e kotë që për një çështje që ngrini ju këtu, unë të diskutoj nëse është apo nuk është për diskutim këtu. Kjo është një autonomi e plotë juaja. Unë nuk dua të zgjatem më tej për këtë tematikë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në parim gjykoj që për çështjet e mëdha, siç është votimi elektronik, votimi i emigrantëve, eventualisht, financimi i partive politike, ne të biem dakord që një nga detyrat që ka grupi i ekspertëve, është të na japë një kalendar aktivitetesh të koordinuara për ato çështje.

Të mos harrojmë që në datën 13 dhjetor OSBE-ja organizon një tryezë të rrumbullakët pikërisht për të asistuar Komisionin e Reformës Zgjedhore për votimin elektronik dhe

përdorimi i teknologjisë në zgjedhje, që është shumëplanësh mund të jetë një nga aktivitetet. Ky mund të futet shumë shpejt në kornizën tonë. Siç do ta bëjmë për votimin elektronik një proces konsultimesh me publikun, me ekspertët, me organizatat ndërkombëtare, me shoqërinë civile, me punë ekspertësh, ashtu do ta bëjmë edhe për votimin e emigrantëve, edhe për financimin e partive politike e ndoshta, do ta bëjmë edhe për administratën zgjedhore.

Ne duhet të biem sot dakord që grupi i ekspertëve, është të na sjellë një kalendar aktivitetesh të paktën për këto 2 çështje madhore. Le të themi 3 së bashku me financimin e partive, nëse duam ta fusim, sepse Këshilli i Europës ka një kontribut të hershëm në këtë aspekt. Mund ta kanalizojmë edhe këtë në atë drejtim.

Të vazhdojmë më tej, nëse ka ndonjë çështje për të shtuar që të mos ta mbyllim ne bashkëkryetarët, nëse ka ndonjë çështje tjetër që duhet shtuar si tematikë për diskutim, ju lutem, a keni çështje të tjera?

**Fatmir Mediu** – Unë e kuptoj shqetësimin e zotit Fino. Konstatimet i ka bërë OSBE/ODIHR-i dhe ne i kemi diskutuar dhe i kemi debatuar politikisht. Çështja është që të fillojmë dhe të veprojmë konkretisht. Me të gjitha ato çka parashtrroi zoti Bylykbashi mendojmë që duhet të bëjmë një ndarje mes çështjeve politike dhe çështjeve teknike. Çështjet politike janë 3: çështja e votimit elektronik, që është prioritet dhe duhet diskutuar sa më shpejt, çështja e shitblerjes së votës, e cila kërkon edhe nivel ekspertize, si dhe çështja e votimit të emigrantëve.

Pastaj janë të gjitha elementet teknike që janë parashikuar në raportet e njëpasnjëshme të OSBE/ODIHR-it, por nëse ne nuk do të të konstituojmë sot grupin e ekspertëve, i gjithë diskutimi ynë me njëri-tjetrin nuk do të arrijë ndonjë rezultat konkret. Do të ishte mirë që ne të përcaktojmë grupin e ekspertëve dhe t'u kërkojmë atyre një matricë veprimi (jo një kalendar pune), duke përcaktuar çështjet, personat përgjegjës dhe afatet kohore.

Sugjeroj që në këtë matricë të vendosen sipas rëndësisë dhe kohës së nevojshme për implementim, në mënyrë që të dimë si mund të na ofrohet edhe asistenca e ekspertëve të huaj në këtë pikëpamje.

**Bledar Çuçi** – Besoj se jemi në të njëjtën linjë. Ne edhe në axhendë e futëm për këtë arsye. Secili nga kolegët, që mendon një çështje përveç... edhe një moment tjetër, por të paktën ta furnizojmë grupin e ekspertëve me listën e të gjitha çështjeve, në mënyrë që ai të bëjë kalendarin. Kjo besoj se është edhe...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, për çështjet. Zoti Bylykbashi listoi gati në mënyrë shteruese, por unë mendoj se ka ende çështje. Unë shtova 2 çështje. Edhe ju mund të keni për të shtuar ndonjë çështje që mund ta fusim për t'u diskutuar nga komisioni për t'u dhënë më pas materialin ekspertëve për të bërë kalendarin sipas çështjeve, nëse ka çështje. Pra, për të qenë sa më eficientë edhe në funksionimin e komisionit, që të paktën të mos dalim me *second thoughts* nga mbledhja ku ne jemi. Ta hedhim çdo çështje këtu në komision dhe më pas, se cili do të jetë vendimi, se si do të jetë rruga e ekspertizës do ta vendosim po bashkë, por të paktën një listë çështjesh, të cilat ne duhet t'i merrnim, ne, si bashkëkryetarë gjykuam që ta ndajmë dhe ta diskutojmë edhe me ju.

Zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti bashkëkryetar!

Unë kam një sugjerim lidhur me pikën 4, ku thuhet: propozim për planin e punës dhe kalendarin e aktiviteteve. Komisioni i mëparshëm *ad hoc*, i cili u ngrit për të bërë reformën zgjedhore dhe nuk e finalizoi punën, nëpërmjet ekspertëve ka bërë një punë paraprake, një dokument shumë të mirë, ku ka renditur të ndarë, ashtu siç tha edhe zoti Mediu, çështjet për të cilat kërkohet vullnet politik dhe çështjet, të cilat janë të karakterit teknik. Njëkohësisht, unë dhe ju që keni qenë anëtarë të këtij Komisioni për Reformën Zgjedhore kemi dijeninë që ka pasur një opinion nga ekspertët e KE-së dhe të ODIHR-it për çështje konkrete, amendime apo propozime për riformulime të Kodit Zgjedhor, bazuar në rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, për zgjedhjet e vitit 2013 dhe të vitit 2015. Këtij raporti mund t'i shtojmë edhe rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, për zgjedhjet e vitit 2017 dhe në këtë mënyrë, është një punë pak më e lehtë.

E dyta dhe e fundit, që do të doja të theksoja, është se në këtë periudhë kemi marrë shumë mendime, opinione, komente dhe sugjerime nga vëzhguesit vendorë dhe ata ndërkombëtarë. Është çasti që listës së rekomandimeve të depozituara në sekretarinë e Kuvendit, por që u ka ardhur me zarfe të gjithë deputetëve të komisionit të mëparshëm, por edhe të këtij komisioni, të listohen të hidhen të gjitha në një dokument. Këtë mund ta bëjë edhe sekretariati teknik i Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore dhe ne t'i dimë të ndara, të sistemuara sipas natyrës së tyre, për ta ditur më pas, kur të bëjmë seancat dëgjimore se si mund të adresojmë pyetjet, si mund të adresohen nga ekspertët dhe kjo do të ishte një lehtësi për punën e këtij komisioni, veçanërisht për ekspertët.

Shumë faleminderit!

**Oerd Bylykbashi** – Zonja Felaj.

**Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Bylykbashi!**

Unë do të thosha në fillim, që shpresoj shumë që të ruajmë në këtë komision një komunikim sa më etik për arsyen e parë dhe të vetme, që duke pasur një komunikim të tillë, ne do të mund të bëjmë ndryshime të plota në atë që kërkohet të bëjmë, si Komision për Reformën Zgjedhore duke mos përsëritur rastet e mëparshme ku komisionet e kanë mbyllur aktivitetin e tyre pa asnjë produkt konkret.

Rastin e solla në vëmendjen tuaj për faktin që nuk ishte produkt i punës së mëparshme të Komisionit për Reformën Zgjedhore, por ishte pikërisht marrëveshja e 18 majit, ajo që solli disa ndryshime, të cilat besoj se të gjithë i kemi parë që ishin të nevojshme dhe të domosdoshme. Ndoshta, nuk u arrit që t'i përmbaheshin 100% ligjit në terren, por sidoqoftë, ishin ndryshime të mira, si për shembull mospërdorimi i mjeteve të propagandës deri në një largësi të caktuar nga qendrat e votimit ose mospërdorimi i administratës publike dhe disa momente të tjera që realisht të gjitha partitë politike dhe të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje i kanë parë si probleme jo të vogla. Shpresoj që ne të ecim realisht në frymën e asaj marrëveshjeje, pa qenë nevoja që arrijmë në momente të tilla kritike, pra të mund të zhvillojmë gjërat me qetësi.

Nga ana tjetër, ju e përmendët në fjalën tuaj që ligji për dekriminalizimin na ndihmon, sepse realisht me atë ligj kemi mundur të bëjmë 2 gjëra:

Së pari, shmangëm maksimalisht futjen e personave të dënuar në listat zgjedhore;

Së dyti, të ndalojmë personat e dënuar me një kategori krimesh të rënda, që të mund të zgjedhin në zgjedhje, duke detyruar në këtë mënyrë edhe Ministrinë e Brendshme, e cila përgjigjet për Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve, që çdo herë që kemi zgjedhje (një herë në 2 vjet) të përdorë rekordet dhe t'i ndalojë disa njerëz nga lista e zgjedhësve, të cilët janë të dënuar, që të mund të votojnë.

Nga ana tjetër, edhe ligji për adresat është një ligj pozitiv, i cili mund të na ndihmojë në diskutimin që do të kemi për votimin e emigrantëve. I solla këto 2 çështje në vëmendjen tuaj për propozimet që unë do të doja t'ia bëja këtij komisioni.

E para, do të doja të kishim një tablo të qartë nga ekspertët të impaktit të të dyja ligjeve (ligjit për dekriminalizimin dhe të ligjit për adresat), sepse ky impakt do të na ndihmojë për të kuptuar se çfarë ndryshimesh të tjera është e nevojshme të bëjmë në të dyja këto ligje. Besoj se ju e thatë, por ndoshta mua nuk më tingëlloi, ashtu sikundër unë e kam shqetësimin.

Ju përmendët çështjen e financimit të partive. Realisht janë të rëndësishme, por besoj se duhet ta bashkëngjitem, ndoshta si një zë të veçantë çështjen e lobimit të partive, sepse edhe

në vendet që kemi përreth (po marr Maqedoninë, nuk po shkoj shumë larg). Ajo ka një rregullore të lobimit edhe për çështjet e ligjeve që ne miratojmë në Kuvendin e Shqipërisë. Shpeshherë ato edhe nga përmbajtja mund të bëhen edhe ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Besoj se duhet ta përmendim si zë të veçantë. Ne vetë (unë mendoj) se kemi nevojë të thellohem më shumë në këto çështje dhe do të na duhej një ekspertizë vetëm për çështjet e lobimit me qëllim që të kuptojmë se deri ku duhet të ndërhyjmë ne, si ligjvënës.

Faleminderit!

**Dashamir Shehi** – Po shikoj këto 5 pikat këtu, përpara dhe gjykoj që ne duhet të merremi dhe ta zgjidhim nga ana praktike punën e ekspertëve se kjo është shumë e kollajtë.

E dyta, është të bëjmë një plan pune dhe një kalendar të aktiviteteve. Edhe kjo është një punë që mund të bëhet sot. Pika e dytë që keni vënë ju, është paraqitja e pozicionit të partive politike. Kjo është një temë e madhe dhe, po të biem dakord, ky është komisioni, sepse zoti Mediu tha që këtu kemi 3 çështje politike. Për mendimin tim ato nuk janë shumë politike. Politika këtu fillon me sistemin, sepse për këtë punë jemi mbledhur, nëse do ta mbajmë këtë sistem apo do ta ndërrojmë. Unë kam ardhur me shpresën që do ta ndërrojmë sistemin. Kjo është një çështje e madhe politike. Nga kjo fillon politika. Nëse do të rrimë me sistemin proporcional rajonal apo do ta bëjmë proporcional kombëtar apo do ta bëjmë proporcional të korrigjuar apo do ta bëjmë sistem maxhoritar? Nuk ka rëndësi kjo. Ka 30 sisteme, nëse do të merremi me sistemin. Sot nuk merremi dot me sistemin.

Çfarë është numërimi elektronik? Kjo është një çështje teknike dhe nuk ka të bëjë fare me politikën, se po me të njëjtin sistem numërohet edhe me dorë, edhe me elektronikë. Atëherë, që ta heqim qafe këtë çështje a do të biem të gjithë dakord të gjithë me votimin dhe numërimin elektronik? Iku dhe kjo. Mund ta mbyllim që sot këtë çështje. Komisioni vendosi që votimi dhe numërimi i ardhshëm të jetë elektronik. Iku dhe kjo, që na ka ngatërruar kaq shumë.

Zonja e tha shumë mirë, që ne nuk do të vazhdojmë çështjet që ka lënë komisioni i mëparshëm. Ajo do të na shërbejë si eksperiencë. Do ta fillojmë të ri, sepse për këtë punë jemi. Do ta fillojmë të ri, sepse do ta fillojmë nga sistemi. Nga kjo do të derivojnë më pas një sërë problematikash të tjera.

Herën e kaluar jemi marrë me adresat e me çfarë nuk jemi marrë. Të gjitha këto gjëra janë shumë të rëndësishme, por ditën që e kemi vendosur që të votojmë në mënyrë elektronike, shumë perplesitete bien, sepse për qark votimit elektronik ngrihen një sërë çështjesh të tjera

teknike (në e ke kartën, cili është numri elektronik, si do të votohet, gishti si do të certifikohet) dhe kjo e mbyll atë pjesë për çështjen e votimit.

Prandaj, a do të biem dakord sot, si ditë e parë dhe unë do të thosha, edhe për lezet të medieeve, të entuziazmit popullor që e bëri këtë gjë komisioni? Po, komisioni vendosi që në zgjedhjet e reja populli shqiptar do të votojë dhe do të numërojë me elektronikë. Iku edhe kjo.

Më pas, mund të merremi me çështje të tjera politike, nëse do të votojnë emigrantët, që është një çështje shumë e madhe politike dhe shumë e rëndësishme, por besoj se ne nuk mund të japim sot rezultat për këtë punë.

Sistemi është kryesori, është kryefjala. Nga sistemet derivon pjesa politike, kurse te pjesa teknike kemi ardhur nga fatkeqësia, sepse ne vjedhim votat e njëri-tjetrit, ndryshe nuk do të merreshim fare me këtë punë.

Prandaj, unë mendoj të gjejmë një marrëveshje mirëkuptimi, principi, që atë që u la përgjysmë herën e kaluar ta bëjmë tani, që kemi kohën e mjaftueshme dhe premtimin financiar, për të cilat komisioni ra dakord që në mbledhjen e parë, kurse teknikalitetet t'i përcaktojmë dhe fusim në ligj kur të vijmë teknikët. Dalim me një marrëveshje për pikën e parë dhe pastaj vazhdojmë me çështjet e tjera.

Unë mendoj që mund të dalim edhe që ditën e parë, përndryshe vazhdojmë me pikën e tretë, propozime për grupin e ekspertëve, dhe pikën e katërt, kalendarin. Paraqitja e pozicioneve të partive do të shtjellohet hap pas hapi, por të heqim njëherë këtë temë. Ose do të biem dakord që do t'i numërojmë me elektronikë, ose nuk do të biem dakord. Kjo kondicionon edhe një pjesë të propozimeve që vijnë nga mbrapa, si depolitizimi i komisioneve, sepse ditën kur do të votohet me elektronikë, bie pesha politike e komisioneve. Si do t'i konsiderojmë pastaj? Të mos hyjmë në këtë punë, por të heqim një problem.

Duke u nisur nga fusha që e kemi pak problem, sigurisht që interpretimet e tjera derivojnë ndryshe nga kjo.

Për aq kohë sa nuk e kemi përcaktuar se si do të votohet, ne diskutojmë kot. Komisioni dhe vëzhguesit marrin një peshë tjetër dhe në vend të adresës elektronike duhet adresa e lagjes. Kështu që, hyjmë në një botë krejt tjetër paralele me këtë.

Kjo është ideja ime, zotërinj bashkëkryetarë.

**Oerd Bylykbashi** – Faleminderit, zoti Shehi!

Zoti Dule e ka fjalën.

**Vangjel Dule** – Faktikisht, unë nuk jam shumë larg propozimeve të zotit Shehi.

Do të më ndjeni, të nderuar bashkëkryetarë, sepse kam një lutje: mos e fusni këtë komision në një mënyrë sklerotike funksionimi, sepse pikërisht kjo ka çuar në dështimet që kemi përjetuar me reformën zgjedhore herët e kaluara! Krijoni një dinamizëm në mënyrën e funksionimit të tij.

Personalisht nuk mund ta konceptoj se si nga momenti që është konsideruar emergjencë, kemi 27 vjet që nuk arrijmë të organizojmë zgjedhje të lira dhe të ndershme dhe të mos e konsiderojmë këtë reformë një çështje emergjence. Çështjet e emergjencës nuk mund të nisin me nge. Në datën 10 nëntor është bërë konstituimi i komisionit, pas 20 ditësh thirret mbledhja e dytë dhe nuk e di se me çfarë ritmi keni ndër mend të na propozoni të ecim. Unë mendoj që të caktojmë ditë konkrete të çdo jave për mbledhjet e komisionit. Me plotësimin edhe të ekspertëve sot, të ketë afate kohore për çdo çështje. Të mos harrojmë se shtyrja e afateve të komisioneve zgjedhore ka rekordin negativ të parlamentit tonë. Shtyje ta shtyjmë.

Nuk duhet ta lejojmë që të futet sërish në këtë hulli funksionimi i këtij komisioni. Këtu jemi dhe mund të japim afate konkrete. Politikisht, ne i rikthehem kot votimit dhe numërimit elektronik, sepse data 18 maj ka shprehur vullnetin e përbashkët të dy partive kryesore politike. Rrjedhimisht, çfarë na mbetet ne?

Kujt do t'ia ngarkojmë teknikisht që të na bëj një, dy, tre propozime variantesh se si mund të organizohet kjo së bashku me ndihmën e *OSBE-ODHIR*-it dhe të partnerëve të tjerë? Kur do ta miratojmë ne si komision? Kur do t'ia çojmë seancës plenare për miratim? Nuk ka asnjë pengesë nga ana funksionale, që me të mbaruar me aspekte konkrete, t'i çojmë për votim në seancën plenare pa pritur përfundimin e të gjithë volumit të çështjeve që duhet të trajtojë ky komision.

Nga ana tjetër, mos e shikoni si hermetike. Ka edhe çështje që mund të dalin rrugës dhe jo vetëm këto që do të deklarojnë ose kanë deklaruar forcat politike në seancën plenare, për të cilat duhet të jemi të hapur, me qëllim që t'i shqyrtojmë në çdo moment që ato mund të na dalin.

Duhet të jemi sa më të hapur në dëgjuesat me grupet e interesit, duke filluar që nga forcat politike, të cilat nuk përfaqësohen në parlament dhe nuk e kanë mundësinë e të shprehurit të qëndrimeve të tyre si në diskutimet parlamentare, por edhe në komisione. Kemi shoqata të ndryshme, të cilat kanë shprehur sistematikisht propozime, mendime, por në të njëjtën kohë edhe vlerësime në lidhje me proceset zgjedhore.

Gjithashtu, duhet të hapemi edhe ndaj grupeve në emigracion për të dëgjuar edhe mendimin e tyre se si e konceptojnë formën dhe mënyrën më të përshtatshme të pjesëmarrjes



në zgjedhje dhe a mund të garantohet kjo nga legjislacioni në fuqi dhe nga mundësitë paralelisht teknike që ka vendi për garantimin e kësaj të drejte.

Faleminderit!

**Oerd Bylykbashi** – Faleminderit, zoti Dule!

Unë i vlerësoj sugjerimet tuaja dhe të zotit Shehi në lidhje me trajtimin e çështjeve më prioritare, si dhe dinamizmin e mbledhjeve të komisionit.

Sigurisht që, ngritja e grupit të ekspertëve dhe hartimi i planit të punës sa më shpejtë, do të na japë mundësinë që edhe ne të përcaktojmë një axhendë të mbledhjeve të komisionit, por është e nevojshme që të mos shkojmë te situata ku i shtyjmë afatet njëherë në tre muaj.

Kësaj herë e kemi vendosur gjashtë muaj, por përsëri edhe 6-mujori mund të na kalojë shumë shpejt pa punë. Kështu që, edhe unë jam dakord për këtë.

Është detyrë jona si bashkëkryetarë, zoti Çuçi, që, në momentin që konkordojmë materialet edhe me grupin e ekspertëve, që do të ngrihet, të përcaktojmë një axhendë për datat që t'ia propozojmë komisionit nëse anëtarët janë dakord.

Për sa i përket çështjes së ekspertëve, OSBE-ODHIR-i, ka bërë një propozim shumë racional në raport: hartimin e qëndrimeve politike për çështje të caktuara.

I tillë është votimi elektronik, kjo edhe për shkak të kohës së madhe që kërkon, E njëjta gjë është për votimin e emigrantëve. Pra, kërkon ekspertizë shumë të madhe, kohë diskutimi dhe zbatimi, por edhe për një apo dy çështje të tjera që do të biem dakord.

Pra, që sot le të themi se komisioni është dakord të fillojë punën. Nëpërmjet grupit të ekspertëve dhe ekspertizës ndërkombëtare, të fillojë të hartojë një kalendar pune për të trajtuar këto çështje, duke filluar nga tryezat e para publike të rrumbullakëta deri te puna e detajuar me propozime konkrete.

Nëse jemi dakord për këto dy çështje, t'i lançojmë dhe më pas biem dakord së bashku edhe për çështjet e tjera.

Kalojmë te pika e tretë: propozime për grupin e ekspertëve.

Në këtë pikë është e rëndësishme që grupi i ekspertëve të ketë një strukturë që garanton edhe këndvështrimin e të gjithëve ne në aspektin tashmë të ekspertit, por edhe efikasitetin e këtij grupi. Janë ata që do të punojnë dhe hartojnë materiale, nuk është grup përfaqësimi, megjithatë është i rëndësishëm edhe raporti.

Pra, le të konkludojmë edhe për këtë çështje në mënyrën më të mirë të mundshme.

**Bledar Çuçi** – Unë mendoj që ne duhet të biem dakord për strukturën.

Gjatë periudhës nga mbledhja e sotme deri në mbledhjen e ardhshme, secili nga kryetarët e partive që janë në komision, pavarësisht se pjesa andej ka vetëm dy, do të duhet të përcaktojë emra konkretë. Të lëmë në dispozicion këtë kohë për t'ia dorëzuar sekretarisë dhe shërbimeve të Kuvendit. Sot ta quajmë strukturën e miratuar, kurse plotësimi i numrave të ngelet për më pas. Prezantimin zyrtar për emrat le ta bëjë secili nga anëtarët e komisionit.

Në këtë mënyrë, ne si bashkëkryetarë, kemi mundësinë që t'i ngarkojmë grupit të ekspertëve porosinë për vendimet që morëm: për çështjet që do të diskutohen, axhendën, kalendarin, që në mbledhjen e ardhshme të na sjellin një axhendë për ta miratuar. Besoj se kjo është edhe më efiçente.

Jemi dakord?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk e di sa. Mund të jetë 4 me 4 ose 3 me 3.

**Gent Strazimiri** - Ekspertët funksionojnë me votë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kështu që, nuk është e nevojshme të jenë patjetër 4 me 4. Përderisa nuk vendosin gjë me votë, nuk është e nevojshme të ketë paritet edhe te kjo punë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk ngelet për aq kosto gjëja.

**Alket Hyseni**– Patjetër që ekspertët janë të domosdoshëm, por duhet të kemi kujdes, sepse nuk mund të abuzojmë dhe të themi që, meqë janë pa të drejtë vote, le ta hapim thesin, sepse paguhen nga taksapaguesit shqiptarë. Ne do të marrim aq ekspertë sa janë të domosdoshëm për punën tonë. Mendoj që tre ekspertë për çdo krah mund të jenë të mjaftueshëm, por le të diskutojmë mundësinë edhe për ndonjë të katërt. Gjashtë ekspertë janë të mjaftueshëm, bile janë shumë. Ata janë në kontekstin e punës së sekretariatit për komisionin. Për shumë arsye le ta mbajmë numrin gjashtë, ku nga secili krah politik të propozohen tre ekspertë në kuptimin e propozimeve për të përzgjedhur ekspertizën më të mirë të mundshme, por jo të abuzojmë dhe të marrim pa fund ekspertë.

**Gent Strazimiri** – Thamë ekzaktësisht të njëjtën gjë. Këtu janë një grup partish politike...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë jam dakord edhe për dy ekspertë, një majtas, një djathtas. Duke qenë se në konfiguracionin këtej, janë disa forca politike, të cilat mund të donin, dy parti bashkë një ekspert, në anën tjetër është e gjitha e njëjta parti politike. Për shkak se këta kërkojnë tre, nuk

është domosdoshmëri të marrim tre edhe këtej. Në këtë mënyrë u kursejmë taksapaguesve shqiptarë dy rroga ekspertësh.

**Bashkim Fino** - Çdo komision bipartizan që është krijuar, në mbledhjen e parë ka caktuar numrin e ekspertëve. Ne nuk mund ta lëmë të hapur, por sot duhet të caktojmë numrin e ekspertëve sipas forcave të ndryshme politike. Emrat mund të mos i caktojmë sot, sepse forcat politike mund t'i sjellin për dy-tre ditë apo një javë, por ata do të jenë prezentë këtu. Kjo është çështja e parë për të cilën ne duhet të marrim vendim.

Së dyti, nuk varen nga numri i ekspertëve problematikat që u listuan në parlament. Të gjitha forcat politike kanë ekspertë nga partitë e tyre, që mund të punojnë (mbase i kanë gati edhe programet, mendimet dhe sugjerimet konkrete), prandaj mjafton që një apo dy ekspertë të vijnë të diskutojnë këtu. Sa më shumë ekspertë të jenë aq më keq është. Ne kemi eksperiencë parlamentare, shumica këtu, shumë të vjetër. Nëse janë tetë apo dhjetë ekspertë, është shumë keq, po të jenë gjashtë, është çka, kurse po të jenë katër është akoma edhe më mirë.

Pra, sa më pak ekspertë në kuptimin e vendimmarrjes do të ishte akoma edhe më mirë.

Për sa i përket çështjes së forcave politike, forca politike në krahun përballë unë shikoj PD-në dhe LSI-në, për sa kohë që kolegët e mi përballë kanë dalë nga sigla e Partisë Demokratike deputetë. Këtu janë të Partisë Socialiste.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nëse duam të jemi konkretë, i kemi ngrënë hakun PDIU-së, e cila ka tre deputetë dhe duhet të ishte pjesëmarrëse në komision.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, të mbaroj!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Duhet të ishte në komision, por pse jo të kishte edhe ekspertë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Çuçi, do mbani rregull për krahun këtej se për krahun tjetër mban Oerdi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më lejo ta mbaroj mendimin.

Mund të flas, apo jo?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të mos ju vij keq, sepse unë i them gjërat ashtu siç janë. Mos u mërzisni për këtë punë.

Në qoftë se do të ketë ekspertë në grupin andej, duhet të ketë PD-ja 1 apo 2, dhe Lëvizja Socialiste për Integrim, nëse do të ketë ekspertë nga ky grup, duhet të ketë vetëm PS-ja, mbase jo tre apo katër, por dy, sepse mjaftojnë për ne.

Madje, unë do t'i propozoj Kryetarit të Kuvendit që, pse jo, anëtarë komisioni mund të ketë edhe partia çame, si dhe të ketë të drejtën e një eksperti.

Kështu, vendosim barazi midis të gjitha forcave politike që janë në parlament. Nëse do të nisemi nga ideja kush ka grup parlamentar, është shumë e thjeshtë të krijojë grup parlamentar edhe PDIU-ja.

Siç i kanë dhënë Fatmir Mediu 6 deputetë, mund ti japim edhe ne dy deputetë PDIU-së dhe krijohe grupi parlamentar. Tre i ka, plus tre ia japim ne, krijohe grupi parlamentar me 6 deputetë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Fatmir, të lutem! Unë nuk jam xheloz pse ke grup parlamentar.

Unë shkoj me kënaqësi te grupi parlamentar i çamëve, pavarësisht që do të votoj gjithmonë për PS-në. Kështu që, nuk shikoj ndonjë gjë të keqe këtu.

Prandaj, unë ju them juve, dy bashkëkryetarëve, që të miratojmë një numër të caktuar, gjashtë ose katër, e ndarë në mes kjo, dhe pastaj grupet e vendosin vetë numrin e tyre. Për shembull, nëse do të vendoset për gjashtë ekspertë, neve mund të mos na duhen tre ekspertë, por dy. Kështu, shpenzojmë edhe më pak.

Propozimi im është që, sot, ne duhet të miratojmë numrin e ekspertëve.

**Dashamir Shehi** – Përtej logoresë së tepërt për një gjë e ka mirë. Për çfarë duhen gjashtë ekspertë? Vendimet do t'i marrim ne, kurse ekspertët janë për anën teknike.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë mendoj që katër ekspertë janë të mjaftueshëm dhe besoj që nuk do të kenë ndonjë ndasi aq të madhe.

Për sa i përket volumit të punës, ajo është tjetër gjë, sepse edhe zyrës së ekspertëve mund t'i vihet ndonjë sekretari. Vendimet do të merren në komision.

Çdo pari do njeriun e vetë. Këtë po ta përmend që të mos na e përmendësh më. Po qe për deputetë, jemi vetë ne këtu më të vjetër se ty.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Oerd Bylykbashi** – Unë besoja se çështjet e tjera ishin më të rëndësishme, por nuk ma mori mendja që kjo do të ishte...

Po, zoti Naço.

**Nasip Naço** – Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë besoj që për marrëveshjen e datës 18 maj të gjithë shqiptarët, por edhe partnerët ndërkombëtarë janë të gëzuar, kurse mënyrën si funksionoi e pamë.

Besoj që ka edhe forca të tjera politike që duhet të japin kontributin e tyre në përmirësimin e Kodit Zgjedhor apo të sistemit zgjedhor që ne duam.

Besoj që një rol të rëndësishëm luan edhe Lëvizja Socialiste për Integrim. Unë propozoj që të jetë me tetë ekspertë, katër nga maxhoranca dhe katër nga opozita.

Besoj se është një numër i mjaftueshëm në mënyrë që të përfaqësohen Lëvizja Socialiste për Integrim, Partia Demokratike, por edhe forcat e tjera politike që janë sot në opozitë.

Se si e bëtë marrëveshjen, ne e pamë te rezultatet. Kemi ardhur këtu që ta përmirësojmë këtë sistem, sepse historikisht kodin e keni përmirësuar ju të dy dhe rezultatet mbas çdo palë zgjedhesh vijjnë për t'u përmirësuar, vijjnë për të parë rekomandimet e OSBE-ODIHR-it dhe jemi në të njëjtën situatë prej rreth 27 vjetësh. Besoj se që të dalim nga ky vorbull, katër ekspertë nga maxhoranca, katër nga opozita... Dikujt i duken shumë. Unë besoj se ju jeni bërë superfuqi ekonomike, keni rritur të ardhurat, po rrisni pensionet. Maxhoranca nuk e ka problem të paguajë katër ekspertë, sepse paguan më shumë në fushatë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Oerd Bylykbashi** – Zoti Fino, ju lutem!

**Bledar Çuçi** – Faleminderit, zoti Naço!

**Oerd Bylykbashi** – Dua të saktësoj diçka.

E para, nuk merren vendime me votim.

E dyta, në fakt, funksionon vetoja. Edhe nëse një ekspert i një partie të madhe të thotë: “Shiko, se kjo nuk bën”, sikur të ketë edhe tre anëtarë, propozimi nuk do të kalojë nëse qëndrimi politik do të shkojë në të njëjtën linjë, kështu që besoj se është e kotë të diskutojmë gjatë. Këta do të jenë njerëz që duhet të bëjnë punë, sepse njerëz që shkojnë vetëm për të folur dhe të mos ulen të shkruajnë, nuk i duhen askujt.

Propozimi i zotit ...

**Bledar Çuçi** – Më falni!

Për ta përmbyllur, duke qenë se ka edhe shumë çështje, edhe numri i ekspertëve mund të hyjë në punë, sepse njëri do të merret me përdorimin e teknologjisë, një do të merret me sistemet, nëse duam t'i shtjellojmë dhe ta shterojmë debatin, një do të merret me votën e

emigrantëve, ndaj mund të ketë punë për ta. Unë propozoj të kemi katër plus katër ekspertë dhe bëhet një grup prej tetë ekspertësh.

Ndërkohë, emrat i caktojme gjatë periudhës në vazhdim.

Jemi dakord me katër plus katër?

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Oerd Bylykbashi** – Zoti Fino, faleminderit!

Për të kaluar te ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Zoti Fino, më duket se ...

**Bashkim Fino** – Unë dhashë argumente pse jam kundër tetë ekspertëve, bashkëkryetar. Tetë ekspertë, megjithëse nuk votohet, por votova kundër, janë shumë dhe ju e kuptoni shumë mirë këtë gjë. Do të ketë probleme midis tetë ekspertëve edhe për të shkruar, edhe për të diskutuar.

Më falni!

Ju, zoti Bylykbashi dhe zoti Çuçi, keni eksperiencë. Keni qenë edhe herë tjetër në komisione të tilla si ekspertë, keni pasur fat të madh dhe ne e kemi për nder që ju kemi bashkëkryetarë. Ju keni qenë ekspertë dhe bashkëkryetarë dhe e dini fare mirë se sa vështirësi ka të jenë tetë deri në dhjetë ekspertë. Nuk e gjen dot kurrë mundësinë për të diskutuar në mënyrë profesionale.

Unë ju bëra një propozim për shkak të eksperiencës që ka ndodhur në vite në parlamentin shqiptar dhe e zgjidhim problemin. Doni t'ju jap një zgjidhje interesante? Mjaftojnë dy ekspertë. Mund të marrim edhe një ekspert të ironisë së madhe, të LSI-së, të vijë nga krahu ynë. Mbani tre ju. Këtë zgjidhje dhashë, venë gjashtë, por jo tetë, sepse janë shumë. Edhe gjashtë janë shumë, madje.

**Bledar Çuçi** – Zoti Fino, e shpjeguat votën.

**Bashkim Fino** – Ta hodha dorezën. E pe?

**Bledar Çuçi** – Mbaroi tani.

**Oerd Bylykbashi** – Për ta mbyllur, zoti Fino, unë jam dakord në parim me atë që thoni ju, megjithatë, është vendim i komisionit dhe e morëm.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Në komision jemi, marrim sërish vendim. Ajo varet edhe nga numri i ekspertëve që do të sillni ju. Ai është numri real i ekspertëve që do të vijnë në këtë komision.

Për të vazhduar...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Bashkim Fino** - Punoni dot me tetë ekspertë? Kam një pyetje për këta, sepse do të jenë pjesë e tavolinës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, pyetja ime për të tri këta është: ju jeni dakord të keni tetë ekspertë apo gjashtë ekspertë? Me sa punohet më mirë? E dinë ata, sepse ata punojnë më shumë.

**Oerd Bylykbashi** – Zoti Fino, nga eksperiencia ime ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Zoti Fino, ju lutem, që ta përfundojmë mbledhjen, nga eksperiencia ime, dikur kam qenë bashkëkryetar i grupit të ekspertëve të OSBE-së, kemi punuar me tetë ose nëntë dhe funksionojnë shumë mirë. Çështja është se nuk funksionon gjithmonë. Këtu është problemi. Pra ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dakord, por të jemi praktikë.

Para se të mbyllim punën e ekspertëve, ne e kemi bërë ftesën për ekspertizën ndërkombëtare në mbledhjen e parë. Ne si bashkëkryetarë do t'u dërgojmë një shkresë zyrtare institucioneve ndërkombëtare që na kanë asistuar historikisht, OSBE-së dhe ODIHR-it, Këshillit të Europës me Komisionin e Venecias dhe Bashkimit European për eksperiencën që ka dhe për ta besoj se kjo çështje nuk ka nevojë për vendim.

Çështja e fundit, pika 4 besoj se u ezaurua tashmë në diskutim, ndaj them se ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, ajo që diskutuam më parë.

Gjykoj se e ezauruam axhendën për sot.

Ju falënderoj!

**MBYLLET MBLEDHJA**